



Prishtinë, 24 qershor 2008
Kodi i ZRRE-së: D_106_2008

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Nenit 15.2 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të amendamentuar me Ligjin Nr.03/L-080;
2. Dispozitat e Nenit 14 të Licencës Operatorit të Sistemit të Transmisionit;
3. Kërkesën për aprovimin e **Standardeve të Sigurisë të Sistemit të Transmisionit dhe Planifikimit të KOSTT SH.A.** të dërguar me date 24 prill 2008, në seancën e mbajtur me datë 24 qershor 2008, **nxori këtë:**

VENDIM

- I. **Aprovohen Standardet e Sigurisë së Sistemit të Transmisionit dhe Planifikimit të KOSTT SH.A.**
 1. Në prill të vitit 2008 KOSTT-i ka ushtruar kërkesën për aprovimin e Standardeve të Sigurisë të Sistemit të Transmisionit dhe Planifikimit.
 2. ZRRE ka shqyrtuar dokumentin në fjalë, dhe pas vlerësimit dhe plotësimit të të njëjtit ka aprovuar atë.
 3. Nga data e pranimit të këtij vendimi apo publikimit të tij në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, KOSTT-i do të publikojë menjëherë në faqen e vet elektronike versionin e aprovuar të Standardeve të Sigurisë të Sistemit të Transmisionit dhe Planifikimit.
 4. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
 5. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e aprovimit ose data e publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
 6. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e lëshimit të tij ose në datën e publikimit të këtij vendimi në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së



Bashkangjitur: Versionet e aprovuara të Standardeve të Sigurisë të Sistemit të Transmisionit dhe Planifikimit të KOSTT SH.A. Në rast të mospërputhshmërisë, do të mbizotërojë versioni në gjuhën angleze në të cilin është punuar versioni origjinal i këtij dokumenti.

Bordi i ZRRE-së:

Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Nysret Avdiu, Anëtar